

BPrAL kolegji-heimerer 	
PrBHE college-heimerer 	
Nr. Prot: 039/23	Data: 17 / 01 / 2023
Prot. No:	Date:
Njësia: 1 Prishtinë	

BPrAL Kolegji Heimerer Prishtinë

RREGULLORE MBI PUNËN DHE FUSHËVEPRIMIN E KËSHILLAVE TË DEKANATEVE

Prishtinë
Shkurt 2022

Në mbështetje të Nenit 14 të Statutit të Kolegjit Heimerer si dhe Nenit 3, Paragrafit 1 të Rregullores së Punës të Këshillit Akademi, Këshilli Akademik i Kolegjit Heimerer, në takimin e mbajtur me datë 21.12.2022, sipas propozimit të Prorektorit për Mësim, aprovoi këtë:

RREGULLORE PËR PUNËN DHE FUSHËVEPRIMIN E KËSHILLAVE TË DEKANATEVE

Neni 1

Qëllimi

- 1.1. Kjo Rregullore përcakton fushëveprimin e Këshillave të Dekanateve si dhe rregullon mënyrën e punës së tyre.
- 1.2. Për secilin dekanat të Kolegjit Heimerer do të formohet një Këshill i brendshëm i Dekanatit përkatës.

Neni 2

Fushëveprimi

Këshilli i Dekanatit ka këto kompetenca:

- 2.1. Propozon pranë Këshillit Akademik programe të reja studimi për hapje, ndryshim ose mbyllje eventuale të profileve përkatëse përmes Prorektoratit për Mësim;
- 2.2. Në bazë të propozimeve të programeve gjegjëse përcakton nevojat për burime njerëzore dhe të tjera në dispozicion të Dekanatit;
- 2.3. Shqyrton dhe adreson nevojën për staf akademik në programet përkatëse, vlerëson raportin vjetor të Dekanatit për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore të Dekanatit, dhe mbi bazën e saj propozon stafin akademik për vitin akademik tek Këshilli Akademik përmes PROM për aprovim;
- 2.4. Përgatitë për Këshill Akademik (KA) kërkesa të gjeneruara nga plani strategjik i zhvillimit të Dekanatit/Programeve për çështje specifike për fushën akademike dhe më gjërë;
- 2.5. Aprovon linjat buxhetore të cilat propozohen tutje tek Rektorja;
- 2.6. Propozon koncepte me të dhëna bazike (bazuar në modelin përkatës institucional) për bashkëpunime ndërkombëtare relevante pranë Prorektoratit për Bashkëpunim dhe Projekte Ndërkombëtare, dhe me kërkesë të të njëjtit ndihmon në përpilimin e propozimeve të prioritizuara në nivel institucional;
- 2.7. Propozon projekte hulumtuese për fushat gjegjëse pranë Prorektoratit për Hulumtime;
- 2.8. Shqyrton propozimet për fillim dhe mbrojtje finale të temave të diplomës;
- 2.9. Emëron Komisionin dhe monitoron realizimin e detyrave të Komisioneve për shqyrtim të çështjeve të lidhura me përmbajtjen e programit (për kontrollimin e testeve sipas Taksonomisë së Bloom-it, monitorimin e ligjëratave/ushtrimeve dhe praktikave, për vlerësimet gjatë javës së cilësisë, etj.);
- 2.10. Propozon për KA mentorin dhe anëtarët e komisionit për punim të temës së diplomës;

- 2.11. Fasilitasi zhvillimin e literaturës (skripta, libra për botime, fletore të praktikave, etj.) dhe propozon ndryshime/ avancim të materialit didaktik pas analizimit profesional; i mbështetur nga komisioni recensues dhe ekipet specifike;
- 2.12. Propozon listën e librave dhe aseteve të nevojshme didaktike sipas nevojave specifike të Dekanatit bazuar në RVV.

Neni 3 **Përbërja e Këshillit të Dekanatit**

- 3.1. Këshilli i Dekanatit përbëhet nga pesë (5) anëtar, prej të cilëve Dekani i programit është anëtar i emëruar sipas detyrës zyrtare, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Dekanatit.
- 3.2. Anëtarët tjerë të Këshillit të Dekanatit do të zgjidhen nga rradhët e stafit akademik të Fakultetit përkatës. Për të qenë anëtar i Këshillit të Dekanatit duhet pasur së paku përgatitjen profesionale në nivelin Master si dhe të jetë staf i rregullt i deklaruar në Agjencionin Kosovar të Akreditimit.
- 3.3. Anëtarët e Këshillit të Dekanatit do të propozohen për aprovim pranë Këshillit Akademik nga ana e Dekanit të Fakultetit përkatës.
- 3.4. Në rast të refuzimit të bazuar të propozimit nga ana e Këshillit Akademik, Dekani përkatës duhet të dërgojë një propozim të ri për takimin e rradhës së Këshillit Akademik.

Neni 4 **Mandati i anëtarëve**

- 4.1. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Dekanatit është tre vite, me përjashtim të anëtarëve që zgjidhen sipas detyrës zyrtare.
- 4.2. Anëtarët e Këshillit të Dekanatit kanë të drejtë të rizgjidhen si anëtar pas çdo skadimi të mandatit.

Neni 5 **Mbledhjet**

- 5.1. Mbledhjet e Këshillit të Dekanatit kryesohen nga Kryesuesi i Këshillit të Dekanatit.
- 5.2. Në rast se mungon Kryesuesi i Këshillit të Dekanatit, atëherë mbledhja kryesohet nga anëtari i parë i përcaktuar nga Kryesuesi. Në rast se edhe anëtari i përcaktuar nga Kryesuesi mungon, atëherë mbledhja kryesohet nga anëtari më i vjetër i Këshillit të Dekanatit.
- 5.3. Kryesuesi i Këshillit të Dekanatit i thërret mbledhjet sa herë që paraqitet nevoja. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Këshillit të Dekanatit duhet të mbahen së paku një herë në muaj dhe së paku një javë para KA.
- 5.4. Anëtarët e Këshillit të Dekanatit ftohen në mbledhje së paku dy ditë para mbajtjes së takimit, përmes ftesës elektronike.
- 5.5. Kryesuesi është i obliguar që të thërras mbledhjen e Këshillit të Dekanatit nëse këtë e kërkojnë së paku 1/3 e anëtarëve të Këshillit të Dekanatit dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim.

Neni 6

Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

6.1. Të gjithë anëtarët e Këshillit të Dekanatit janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit të Dekanatit.

6.2. Në rast të mos-pjesëmarrjes në takim pa arsye, për një periudhë prej tre (3) muajsh, automatikisht nënkuptohet se personi ka hequr dorë nga mandati i anëtarit të Këshillit të Dekanatit. Në këtë rast zbatohet procedura e zgjedhjes sipas Nenit 3 të kësaj Rregulloreje.

6.3. Në fillim të mbledhjes, Kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës dhe konstaton miratimin apo jo të rendit të ditës.

6.4. Kuorumi konsiderohet se ekziston kur prezent janë shumica (+50%) e anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit të Dekanatit.

Neni 7

Vendimmarrja dhe votimi

7.1. Vendimet e Këshillit të Fakultetit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe janë të obligueshme. Propozimet e Këshillit të Dekanatit duhet të miratohen nga ana e Këshillit Akademik.

7.2. Vendimet e Këshillit të Dekanateve mund të ndryshohen vetëm me kërkesë të Këshillit Akademik.

7.2. Para se të votohet, Kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me çështjen që vendoset.

7.3. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve sipas pikës së rendit të ditës, Këshilli i Dekanatit merr vendim apo nxjerr konkluzione. Kryesuesi i Këshillit duhet të konstatoj aprovimin apo refuzimin dhe e njejta duhet të pasqyrohet në procesverbal.

7.4. Votimi bëhet “për”, “kundër” dhe “abstenim”. Kryetari i Këshillit të Dekanatit ka të drejtën e vetos në votim. Në rast të numrit të votave të barabarta, vota e Kryetarit të Këshillit është vendimtare. Në rast të mungesës së Kryetarit të Këshillit dhe votave të barabarta, propozimi konsiderohet i refuzuar.

Neni 8

Procesverbali nga mbledhja

8.1. Në çdo mbledhje të Këshillit të Dekanatit duhet mbajtur procesverbalin e takimit i cili nënshkruhet nga Kryesuesi dhe nga procesmbajtësi.

8.2. Procesmbajtës është përgjegjësi për procese mësimor brenda Dekanatit përkatës.

8.3. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:

8.3.1. Vendi, datën, kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes;

8.3.2. rendin e ditës

8.3.3. listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë;

8.3.4. shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes;

8.3.5. të gjitha propozimet, vendimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse

8.3.6. Nënshkrimin e Kryesuesit dhe procesmbajtësit.

Neni 9 **Dispozitat përfundimtare**

9.1. Për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje kujdeset Kryetari i Këshillit të Dekanatit.

9.2. Interpretimin autentik të dispozitave të kësaj Rregulloreje e bënë Këshilli Akademik i Kolegjit Heimerer

Neni 10 **Hyrja në fuqi**

10.1. Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Akademik.

Datë: 21/12/2022

Rektore e Kolegjit HEIMERER



Prof. Ass. Dr. Naime Brajshori

